# DËSHMI ARKIVI

**A-472236**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit |
| ADRESA | https://prapaskena.com/2026/09/26/i-denuar-per-vrasjen-e-bashkeshortes-49-vjecari-gjendet-i-pajete-ne-burgun-e-recit/ |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 17:34:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 17:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | cd5a2708c6d8f581274bf4d75687f0a962796fcdd99a967393b484a914e5e978 |
| TEKSTI | f0de7e6943da38f6941aebd3b517e7a3c5940c70a6bbddf3770fb097fd6e07a9 |
| PAMJA | 793f90ff425387b190ad0f2f9efdcec4ce782219a32f8a1d8687b27bcf37119e |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | f21cce5529d7b60801c318eb197e8110cf625728f2c28f5dbea0428ae84dc5b1 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f21cce5529d7b60801c318eb197e8110cf625728f2c28f5dbea0428ae84dc5b1

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# I dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit

Kronike

Publikuar: 26/09/2026



Një 49-vjeçar, i dënuar për vrasjen e bashkëshortes i ka dhënë fund jetës në burgun e Reçit. 49-vjeçari, Agron Llapushi është gjetur i pajetë në ambientet e dusheve të institucionit të vuajtjes së dënimit.

Llapushi mësohet se ishte dënuar me 24 vite e 4 muaj burgim për vrasjen e bashkëshortes së tij.

Ndërkaq, autoritetet e burgut kanë nisur procedurat e nevojshme hetimore për të sqaruar rrethanat e ngjarjes.

Agron Llapushi, 49 vjeç, i lindur në fshatin Holtas dhe banues në Çekin të Gramshit, ishte i dënuar me 24 vjet e 4 muaj burg për vrasjen e bashkëshortes së tij, Alketa Llapushi, në vitin 2015.

Sipas dosjes, Llapushi, pas kthimit nga emigrimi në Greqi, rreth moshës 39-vjeçare, vrau bashkëshorten në një arë në Gramsh, në tokën e quajtur "Mhalla e Lepurit". Ai e mbyti me duar duke e shtrënguar në fyt derisa ajo humbi ndjenjat dhe më pas i shtrëngoi litarin në qafë.

Çifti kishte dy fëmijë, të cilët asokohe ishin të vegjël.Llapushi u dorëzua vetë në polici dhe pranoi krimin. Ai deklaroi se konflikti kishte motive ekonomike, se jetonin në kushte të vështira dhe se para ngjarjes kishte pasur çrregullime mendore e depresion (madje kishte shkuar te një psikolog në Elbasan). Prokuroria për Krime të Rënda kërkoi burgim të përjetshëm, por Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e dënoi me 24 vjet e 4 muaj për "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare" (neni 79/c i Kodit Penal).

Vendimi mori formë të prerë më 10 dhjetor 2015; ai ishte arrestuar më 1 prill 2015, ndërsa ekspertiza psikiatrike konkludoi

Me te lexuarat


33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me "grupin e kokainës" për "Kullën e Tiranës"


Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj


Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit


40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fikt...


Porti i Durrësit drejt zhvendosjes, por Liburn Ali nuk ndalon tenderat, miliona euro për godinat ...

se Llapushi nuk vuante nga sëmundje psikike apo neuropsikike dhe se simptomat që pretendoheshin nuk plotësonin kriteret për sëmundje madhore mendore.

Gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Reçit, ai pati shumë pak kontakte me familjarët: vetëm një takim në 2023 dhe një tjetër në 2025. Për pjesën tjetër të kohës nuk e kishte vizituar askush, ndërsa sot është gjendur i pajetë në ambientet e këtij burgu.

**TAG:** Agron llapushi | Burgu i reçit

## Të ngjashme




**Kush është Indrit Dokle, që u rishpall në kërkim nga SPAK ditën e sotme për akuzat e trafikut të drogës dhe grupit kriminal?**

**U arrestua me urdhër të SPAK, kush është "i forti" i Shkodrës! (Emri)**



**'Kemi besim të plotë te SPAK' Komisioni Europian për arrestimin e Vlora Hysenit: Ndjekim nga afër zhvillimet! Shqipëria progres në luft...**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë



Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.